

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË
P.no. 06/2011
1 Mars 2012

NË EMËR TË POPULLIT

Trupi Gjykses i Gjykatës Qarkut në Mitrovicë, i përbërë prej Gjyqtarit të EULEX-it Nikolaz Entchev, në rolin e Kryetarit të Trupit Gjykses, Gjyqtari Beqir Halili dhe Gjyqtarja e EULEX-it Katja Dominik si anëtarë të kologjit, në çështjen penale kundër:

S. I., i akuzuar me Tentativë për Vrasje të Rëndë, në kundërshtim me Nenin 147, pika 4 dhe 11, i lexuar me Nenin 20 dhe 23 të KPK-së, dhe me Mbajtje në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve, në kundërshtim me Nenin 328, Paragrafi 2 i KPK-ës;

A. I., i akuzuar me Tentativë për Vrasje të Rëndë, në kundërshtim me Nenin 147, pika 4 dhe 11, i lexuar me Nenin 20 dhe 23 të KPK-së, dhe me Mbajtje në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve, në kundërshtim me Nenin 328, Paragrafi 2 i KPK-ës; dhe

J. I., i akuzuar për Ndhimesë në kryerjen e veprës penale të Tentativës për Vrasje të Rëndë, në kundërshtim me Nenin 147, pika 4 dhe 11, në lidhje me Nenin 25, paragrafi 1 dhe 2 i KPK-ës,

Pas mbajtjes të seancave të shqyrtimit kryesor hapur për publikun në datat 8, 9, 10, 27, 28, 29 Shkurt dhe 1 Mars 2012, të gjitha në prani të të tre Akuzuarëve, avokatit mbrojtës Pashë Kuçi për **S. I.**, Isa Osdautaj për **A. I.** dhe Gani Rexha për **J. I.**, Prokurorët Publik të EULEX-it Nancz Casas me 8 Shkurt 2012 dhe Adebayo Kareem në seancat e tjera, palët e dëmtuara F. X., A. K. dhe J. H. në datat 8, 9 dhe 10 Shkurt 2012; pas shqyrtimit të trupit gjykses dhe votimit të mbajtur me datën 1 Mars 2012, në të njëjtën ditë, sipas Nenit 392, Paragrafi (1) i Kodit Procedural Penal të Kosovës (KPPK), shqiptoi në publik dhe në prani të të Akuzuarëve të lartpërmendur, Avokatëve të tyre Mbrojtës dhe Prosekutorit Publik të EULEX-it, si më poshtë

AKTGJYKIM

(I)

S. I., djali i M. I. dhe i E. G., lindur më _____ në _____, me banim të përhershëm në _____, Komuna _____,

është

I SHPALLUR FAJTOR

(A)

Sepse me datë 24 Qershor 2010 rreth orës 08.40, i akuzuari, në bashkëpunim me **A. I.**, qëlluan disa herë me armë zjarri të llojit të panjohur, i kalibrit 7.62 x 25 në drejtim të palëve të dëmtuara F. X., A. K. dhe I. H. me qëllim të privoj ato nga jeta e tyre. Të shtënat ndodhën

brenda Kuvendi Komunal në Skenderaj, gjatë orarit të punës, në korridor ku është hyrja për zyrën nr. 4, gjatë kohës kur palët e dëmtuar ishin duke iu afruar hyrjes të kësaj zyre me synim për të marrë një certifikatë për transferim të pronës së patundshme. Persona të tjerë kanë qenë të pranishëm në afërsi të vendit ku ndodhën të shtënat.

Si pasojë e të shtënave, të tre palët e dëmtuara janë plagosur si në vijim: I. H. ka marrë dy plagë: në kokë dhe në gjoks të cilat e kanë lënduar rëndë duke rrëzuar jetën e tij; si rezultat i plagosjes në kokë ai ka pësuar humbje të përhershme të syrit të tij të majtë; A. K. ka marrë tre plagë, një në gjoks, një në zonën e mesit dhe një në pjesën e gjurit të djathtë të cilat kanë lënduar rëndë dhe rrëzuar jetën e tij; F. X. ka marrë një plagë në gjurin e tij të majtë.

Motivi i sjelljes kriminale i të Akuzuarve është një konflikt me palët e dëmtuar në lidhje me pronësinë e pronës së patundshme të lartpërmendur. Të pandehurit, pas të shtënave, u larguan nga vend-ngjarja dhe shkuan në drejtim të panjohur.

I pandehuri duke bërë kështu, në bashkëpunim me **A. I.**, ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale të Tentativës për Vrasje të Rëndë në kundërshtim të Nenit 147, pika 4 dhe 11 në lidhje me Nenin 20 dhe 23 të KPK-ës.

Veç kësaj, i pandehuri

është

I SHPALLUR FAJTOR

(B)

Për shkak se në të njëjtën ditë, vend dhe orë siç është e shënuar në pikën A të dispozitivit, i pandehuri ka përdorur një armë zjarri të llojit të panjohur të kalibrit 7.62 x 25, në mënyrë siç të përmendur më lart, pa pasur leje të vlefshme,

I pandehuri duke bërë kështu, ka kryer dhe është penalisht i përgjegjshëm për veprën penale **të Mbajtjes në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve**, në kundërshtim me Nenin 328, Paragrafi (2) i KPK-ës;

(II)

A. I., djali i M. I. 2. dhe i H. M., lindur më _____ në _____, me banim të përhershëm në _____, Komuna _____,

është

I SHPALLUR FAJTOR

(A)

Sepse me datë 24 Qershor 2010 rreth orës 08.40, i pandehuri, në bashkëpunim me **S. I.**, qëlluan disa herë me armë zjarri të kalibrit 7.62 x 25 në drejtim të palëve të dëmtuar F. X., A. K. dhe I. H. me qëllim të privojnë ato nga jeta e tyre. Të shtënat ndodhën brenda Kuvendit Komunal në Skenderaj, gjatë orarit të punës, në korridor ku është hyrja për zyrën nr. 4, gjatë kohës kur palët e dëmtuar ishin duke iu afruar hyrjes të kësaj zyre me synim për të marrë një certifikatë për transferim të pronës së patundshme. Persona të tjerë kanë qenë të pranishëm në afërsi të vendit ku ndodhën të shtënat.

Si pasojë e të shtënave, të tre palët e dëmtuara janë plagosur si në vijim: I.H. ka marrë dy plagë: në kokë dhe në gjoks të cilat e kanë lënduar rëndë duke rrëzuar jetën e tij; si rezultat i plagosjes në kokë ai ka pësuar humbje të përhershme të syrit të tij të majtë; A. K. ka marrë tre plagë, një në gjoks, një në zonën e mesit dhe një në pjesën e gjurit të djathtë të cilat kanë lënduar rëndë dhe rrëzuar jetën e tij; F. X. ka marrë një plagë në gjurin e tij të majtë.

Motivi i sjelljes kriminale i të Pandehurit është një konflikt me palët e dëmtuar në lidhje me pronësinë e pronës së patundshme të lartpërmendur. Të pandehurit, pas të shtënave, u larguan nga vend-ngjarja dhe shkuan në drejtim të panjohur.

I pandehuri duke bërë kështu, në bashkëpunim me **S. I.**, ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale të Tentativës për Vrasje të Rëndë në kundërshtim të Nenit 147, pika 4 dhe 11 në lidhje me Nenin 20 dhe 23 të KPK-ës.

Veç kësaj, i pandehuri

është

I SHPALLUR FAJTOR

(B)

Për shkak se gjatë një periudhe kohe të paditur deri me datën 24 Qershor 2010, ai ishte në posedim të paautorizuar të një pistolette të llojit “modelit CZ 52” me numër serial “M09385”, të kalibrit 7.62 x 25; dhe në të njejtën ditë, vend dhe orë siç është e shënuar në pikën A të dispozitivit, i pandehuri ka përdorur të njejtën armë në mënyrë siç të përmendur më lart.

I pandehuri duke bërë kështu, ka kryer dhe është penalisht i përgjegjshëm për veprën penale **të Mbajtjes në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve**, në kundërshtim me Nenin 328, Paragrafi (2) i KPK-ës;

(III)

J. I., djali i **S. I.** dhe **Z. I.**, i lindur në datën _____ në fshatin _____ ku ai banon

është

SHPALLUR I PAFAJSHËM

sepse nuk është provuar që i pandehuri ka kryer veprën penale me të cilën ai është akuzuar. Kjo do të thotë që nuk është vërtetuar që i pandehuri, i pati premtuar **S. I.** dhe **A. I.** që t'i ndihmonte ato për të fshehur mjetin e kryerjes së krimit dhe identitetin e autorëve, apo të siguroj largimin e tyre nga vendi i ngjarjes, dhe gjithashtu nuk është provuar që ai ka ndihmuar ato që të largohen nga vend-ngjarja duke i lejuar ato të hidhen nga dritarja e zyrës së tij në Kuvendin Komunal të Skenderaj, të përdorin një makinë Mercedes për tu larguar nga afërsia e ndërtesës Komunale dhe të fsheh gjurmët e krimit nga rrobat e **S. I.** dhe **A. I.**

Kështu që, sipas Nenit 390, pika 3 i KPPK-ës, i Akuazuari është shfajësuar nga akuza e Ndihmesës të kryerjes së veprës penale të Tentativës për Vrasje të Rëndë, në kundërshtim të Nenit 147, pika 4 dhe 11 në lidhje me Nenin 25, paragrafi 1 dhe 2 i KPK-ës.

DËNIMI

S. I. është

DËNUAR

- me nëntë (9) vjet burgim për veprën penale për Tentativë për Vrasje të Rëndë
- me një (1) vit dhe gjashtë (6) muaj burgim për veprën penale të Mbajtjes në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve

Dënimi i përmbledhur është përcaktuar për nëntë (9) vjetë e nëntë (9) muaj burgim sipas Nenit 71 Paragrafi (1) dhe Paragrafi (2), Pika (2) e KPK-ës. Koha që është kaluar në paraburgim që nga data 09 Korrik 2010 do të kreditohet sipas Nenit 73, Paragrafi (1) i KPK-ës.

I pandehuri duhet të paguaj 261 Euro si pjesë e tij e shpenzimit të procedurave penale, duke përfshirë pagesën e dëshmitarit ekspert dhe përjashtuar shpenzimet e interpretimit dhe përkthimit, sipas Nenit 102, Paragrafi (1) i KPPK-së.

A. I. është

DËNUAR

- me nëntë (9) vjet burgim për veprën penale për tentativë për Vrasje të Rëndë
- me dy (2) vjet burgim për veprën penale të Mbajtjes në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve.

Dënimi i përmbledhur është përcaktuar për dhjetë (10) vjetë burgim, sipas Nenit 71 Paragrafi (1) dhe Paragrafi (2), pika (2) i KPK-ës. Koha që është kaluar në paraburgim që nga data 09 Korrik 2010 do të kreditohet sipas Nenit 73, Paragrafi (1) i KPK-ës.

I pandehuri duhet të paguaj 261 Euro si pjesë e tij e shpenzimit të procedurave penale, duke përfshirë pagesën e ekspertit dhe përjashtuar shpenzimet e interpretimit dhe përkthimit, sipas Nenit 102, Paragrafi (1) i KPPK-së.

Januz Ismajli lirohet nga pagesa e ndonjë shpenzimi që ka lidhje me procedurat meqenëse Avdyl Ismajli është shfajësuar nga të gjitha akuzat.

Palët e dëmtuar janë të udhëzuar që mund të bëjnë kërkesë për kompesime në kontest civil sipas Nenit 112, paragrafi 2 i KPPK-ës.

ARSYETIMI

1. Historia Procedurale

Aktakuza në këtë rast është dorëzuar nga Prokurori i Qarkut në Mitrovicë në datën 9 Dhjetor 2010 dhe u konfirmua me 20 Janar 2011.

I akuzuari **S. I.** dhe **A. I.** ishin akuzuar për Tentativë për Vrasje të Rëndë sepse në datën 24.06.2010 rreth orës 08.40 minuta, në hyrje të zyrës numër 4 të Drejtorisë së kadastrës dhe Gjeodezisë të Kuvendit Komunal në Skenderaj, ato në bashkëpunim dhe para-marrëveshje qëlluan me armë në drejtim të viktimave F. X., A. K. dhe I. H., pasi viktimat u futën brenda Kuvendit Komunal në drejtim të zyrës nr. 4 në Drejtorinë e kadastrës dhe gjeodezisë. Aktakuza pohon që të Akuzuarit po qëllonin pa ndërprerje ku si pasojë viktimat I. H. është goditur në kokë dhe në gjoks disa herë, ku si rezultat ai ka pësuar lëndime të rënda trupërore në atë moment duke rrëzuar jetën e tij; viktimat A. K. është goditur me plumba duke shkaktuar atij lëndime të rënda trupërore në atë moment duke i rrëzuar jetën e tij; viktimat F. X. ishte goditur nga një plumb në këmbën e tij të majtë nën gju dhe ka pësuar lëndime trupërore. Gjithashtu supozohej që pasi ato ishin të bindur që kanë vrarë viktimat, të Akuzuarit u larguan nga vend-ngjarja dhe vrapuan në drejtim të paditur,

I akuzuari **S. I.** dhe **A. I.** ishin gjithashtu të akuzuar për Mbajtje në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve, pasi në të njëjtën ditë, vend dhe orë siç tregohet më lart, ato kanë përdorur armë zjarri pa leje të vlefshme për mbajtje dhe përdorim armësh; **S. I.** supozohej që ka përdorur pistoletë të tipit “CZ model 52” prodhim Çeko-slllovak me numër serial “M 09385” duke qëlluar viktimat F. X., A. K. dhe J. H., ndërsa **A. I.** ishte duke përdorur armë zjarri të llojit të panjohur me kalibër 7.62 x 22 mm për të njejtin qëllim.

I akuzuari **J. I.** ishte akuzuar për Ndhimesë në kryerjen e veprës penale të Tentativës për Vrasje të Rëndë sepse në të njëjtën ditë, vend dhe orë siç e treguar më lart, **J. I.** i premtoi **S. I.** dhe **A. I.** që ai do të ndihmonte në kryerjen e veprës penale kundër viktimave F. X., A. K. dhe J. H. duke i fshehur mjetet e kryerjes dhe identitetin e autorëve dhe siguroj largimin e tyre nga vend-ngjarja; supozohej që pas kryerjes së Tentativës për Vrasje të Rëndë me ndihmën e **J. I.**, të dy të akuzuarit e tjerë **S. I.** dhe **A. I.** u larguan nga vend-ngjarja nga zyra e tij nr.6; që të tre nga këta, së bashku mbyllën derën nga brenda dhe kërcyen nga dritarja dhe pastaj u larguan shpejt me makinë të tipit Mercedes në drejtim të paditur.

Në datën 15 Qershor 2011, rasti u është caktuar Gjyqtarëve të EULEX-it të Mitrovicës/ Gjykatës Qarkut, nga vendimi i Kryetarit të Kolegjit të Gjyqtarëve të EULEX-it.

Shqyrtimi kryesor është mbajtur në datat 8, 9, 10, 27, 28, 29 Shkurt dhe 1 Mars 2012. Në datën 8 Shkurt 2012, që të tre të Akuzuarit u deklaruan të pafajshëm për të gjitha akuzat.

I akuzuari **S. I.** dhe **A. I.** kanë qenë në paraburgim që me 09 Korrik 2010.

2. Kompetenca e Gjykatës

Gjykata e Qarkut në Mitrovicë është kompetente për të dëgjuar këtë rast sipas Nenit 23 pika 1) i) dhe Nenit 27 paragrafi (1) i KPPK-së.

3. Lista e Provave të Paraqitura

Këto dëshmitarë janë dëgjuar gjatë rrjedhës të shqyrtimit kryesor:

Palët e dëmtuara F. X., A. K. dhe J. H., në datën 8 Shkurt 2012.

N. I. (dëshmitarë i ftuar nga Prokuroria), V. M. (dëshmitarë i ftuar nga Prokuroria) dhe H. S. (dëshmitarë i ftuar nga Prokuroria), në datën 9 Shkurt.

Sh. H. (dëshmitarë i ftuar nga Prokuroria), B. K. (dëshmitarë i ftuar nga Prokuroria), dhe F. B. (dëshmitarë i ftuar nga mbrojtja e **J. I.**), në datën 10 Shkurt.

T. G. (dëshmitar ekspert mjeko-ligjor i emëruar nga Kolegji sipas kërkesës të Mbrojtjes) dhe F. B. 2. (dëshmitarë i ftuar nga mbrojtja e **J. I.**), në datën 27 Shkurt.

Këto dokumenta ishin pranuar si evidencë dhe lexuar në proces-verbal, në datën 28 Shkurt:

Nga Dosja # I e dosjes së Prokurorisë:

- Akuzat Penale kundër **S. I., A. I. dhe J. I.**, faqet 88-93.
- Raporti i Oficerit –S. M., KP#____; Raporti i Oficerit-L. G., KPPK#____; Raporti i Oficerit-R. K., KP#____; Raporti i Oficerit-A. L., KP#____; Raporti i Oficerit-S. G., KP#____; Raporti i Oficerit-Q. M., KP#____; Raporti i Oficerit-I. B., KP#____; Raport mbi informacionin e Hetimit-Drejtoria e Krimeve të Rënda-Masar Seven#6249, faqet 94-113.
- Procesverbali i intervistës të F. X., faqet nga 189-192
- Përgjimi i telefonit celular VALA, faqet nga 291-304
- Urdhri i Gjykatës Qarkut në Mitrovicë për Laboratoring e Krimeve të PK për ekspertizë balistike, faqet nga 313-316.
- Letër me numër çështje: Sh./Z 10-11/2010, faqet nga 341-344.

Të gjitha dokumentat e përfshira në dosjen II të dosjes të Prokurorit, domethënë:

- Përmbajtja e dosjes mjeko-ligjor, nr. 10-089
- Raport mjeko-ligjor i egzaminimit të vend-ngjarjes
- Lista e provave- zinxhir i kujdestarisë (vend-ngjarje)
- Lista e provave- zinxhir i kujdestarisë (QKUK-Prishtina)
- Raport shtesë i Hetuesit rajonal
- Lista e provave- zinxhir i kujdestarisë (pistoletës)
- Skicë me legjendë
- Regjistri i hyrjes në vend-ngjarje
- Raport kërkimi

- Raport shtesë, PK B. Rr. # _____
- Raport shtesë, PK B. O. # _____
- Lista e armëve të konfiskuara
- Forma e Laboratorit Qëndror të Krimeve (A, D dhe B),
- Kërkesë për egzaminim të evidencës (C)- KP Masar Seven
- Formë Expertize e Lab Qëndror të Krimeve (D dhe B)
- Njësia e Ekspertizës së armëve të zjarrit
- List e shkarkimit nga SHKPP, nr. matrix 194/10
- Konkluzioni laboratorik
- Albumi i fotografive të vend-ngjarjes, 10-089
- Albumi i fotografive të zyrave në katin e parë të ndërtesës KK.
- Albumi i fotografive të dyshuarëve, 10-089
- Albumi i fotografive të pistoletës, 10-089
- Albumi i fotografive të makinës 300-KS-707 me dokumentat mbi detajet e makinës

Gjatë gjykimit, një inçizim video (DVD) që gjoja tregonte të tre të akuzuarit në kohën e incidentit, e kapur nga kamerat e qendrës tregtare Ben-Af në Skënderaj të vendosura afër ndërtesës së Komunës, ishte parë nga të gjitha palët dhe kolegji.

Gjatë seancës të shqyrtimit kryesor në datën 28 Shkurt, që të tre të Akuzuarit paraqitën deklaratat dhe iu përgjigjën pyetjeve.

4. Përmbledhja e Provave të Paraqitura

A) *Provat në lidhje me akuzat e Tentativës për Vrasje të Rëndë në kundërshtim të Nenit 147, pika 4 dhe 11 kundër S. I. dhe A. I.*

Dëshmitë e të tre palëve të dëmtuara

Shpjegimet për incidentin të dhëna nga të tre Palët e Dëmtuara në dëshmitë e tyre pajtohen në paraqitjen e fakteve si në vijim: F. Xh., A. K. dhe I. H. thanë që më 24 Qershor 2010, rreth orës 8.30-8.40 para dreke, ato shkuan te ndërtesa e Komunës Skenderaj të marrin një çertifikatë në lidhje me pronësinë e pasurisë së paluajtshme poshtë në qytetin Skenderaj, në lidhje të së cilës egzistonte një konflikt me familjen e të Akuzuarëve.

Në lidhje me këtë konflikt, A. K. dhe I. H. dëshmuan që disa ditë më përpara incidentit, M. I. 2., (babai i A. I. dhe axha i S. I.) dhe J. I. (vëllai i M. I. 2. dhe axha i A. I. dhe S. I.) erdhën në shtëpinë e I. H. dhe paralajmëruan ato që të mos blejnë tokën pasi ajo ishte i I.. Ato gjithashtu ishin kërcënuar që, në rast se do të vazhdonin me blerjen e tokës, gjak do të derdhej. F. Xh., me 8 Qershor 2010, raportoi në polici, që fisi I. donin që të ndalonin me forcë I. H., A. K. dhe atë që të hyjë në posedim të pronës që kishin blerë nga pronarë të ligjshëm (shiko fq. 189-192, Dosja #I e Prokurorit)

Kur iu afruan Komunës në datën 24 Qershor 2010, F. Xh., I. H. dhe A. K. vunë re prezencën e të Akuzuarëve **S. I.** dhe një apo dy persona që po vinin në drejtim të ndërtesës. Sapo u fut në ndërtesë, I. H. takoi N. I., një punëtor të Komunës, dhe e pyeti atë nëse zyra e kadastrës ishte e hapur, së cilës ai iu përgjigj pozitivisht. Ashtu siç të tre prej tyre po ecnin përmes korridorit dhe sapo ishin duke hyrë në zyrën e kadastrës (zyra nr. 4), F. Xh. ishte i pari, afër derës së zyrës, A. K. ishte i dyti dhe I. H. i treti. Në momentin kur Zt. F. Xh. ishte në pikën e hyrjes në zyrë dhe I. H. ishte duke folur në telefon celular, të shtënat erdhën nga ana e korridorit ngjitur me hyrjen. I. H. pa dy persona duke qëlluar kundrejt tij me pistoleta, njëri prej tyre kishte mjekër cjapi (shpjegim –mjekër rreth gojës), i cili më vonë e konfirmoi që ishte **S. I.** Ndërmjet Palëve të Dëmtuara, ai ishte më i afërti nga vinin të shtënat; pasi është goditur në faqen e tij, ai ka humbur vetdijen. Ai ka ardhur në vetdije kur ishte në spital, ku e kuptoi që ishte plagosur nga një plumb në syrin e majtë (të cilin e humbi) dhe një tjetër në gjoks.

Gjithashtu, F. Xh. dhe A. K. kanë njohur **S. I.** së bashku me **A. I.** duke shtënë në drejtimin e tyre nga një distancë prej 4-10 metra. Ata që të dy kanë parë I. H. të goditur dhe duke u rrëzuar.

F. Xh. dëshmoi që ai është goditur nga një plumb në këmbën e tij të majtë, poshtë gjurit dhe ka treguar plagën në sallën e Gjyqit. Sapo u plagos, ai hyri në zyrën nr. 4, gjatë kohës që të shtënat vazhdonin në korridor. Ai ka parë një punëtore femër në zyrë, dhe është larguar nga zyra nga dritarja, ku ka arritur në parkimin e Komunës. Ai konfirmoi që të dy të pandehurit kanë qenë duke qëlluar dhe që ishin dy armë që qëllonin.

A. K. dëshmoi që ai është goditur katër herë, tre të shtëna kanë goditur atë në pjesët jetike të trupit dhe një në gjurin e tij, para se mund të futej në zyrën nr. 8, e cila gjendet përballë zyrës nr. 4. Gjatë kohës që të shtënat vazhdonin në korridor, ai nxjerri pistoletën e tij dhe nga brenda zyrës me derën hapur, ka shtënë disa herë në murë, përballë hyrjes së zyrës në korridor që të mbante qëlluesit në distancë. Siç të shtënat vazhdonin (ai ka dëgjuar përafërsisht 20 të shtëna totalisht) ai u largua nga zyra nga dritarja dhe pastaj është transportuar në spital ku ka qëndruar për 12 ditë.

Secili nga palët e dëmtuara, në një pikë të deklaratave përkatëse të tyre kanë emëruar **S. I.** dhe **A. I.** si të dy personat që kanë qëlluar ato në datën 24 Qershor 2010.

Dëshmitë e dëshmitarëve N. I., H. S., B. K., S. H. dhe V. M..

Dëshmitarët N. I., H. S. dhe B. K., në dëshminë e tyre në Gjykatë, vërtetuan disa aspekte të rëndësishme të versionit të dhënë nga të tre Palët e Dëmtuara.

Ashtu siç Zt. N. I. dëshmoi, me 24 Qershor 2010 ai, punëtor që punon në zyrën e kadastrës së Komunës, ishte duke pirë një cigare në zonën ku lejohet të pihet duhani, që gjendet menjëherë pas hyrjes në Komunë. Ka qenë një ditë normale pune. Ai ka parë I. H., A. K., dhe F. X. duke hyrë në Komunë dhe i ka përshëndetur ato pasi ka njohur I. H. dhe A. K.. Ashtu

siç Palët e Dëmtuara vazhduan të futen brenda ndërtesës, menjëherë pas pak kohësh, ai ka parë **S. I.** dhe **A. I.** duke hyrë në Komunë. Ai i ka njohur ato pasi janë nga i njëjti fshat. Pak më vonë, ai ka dëgjuar shkëmbime të shtëna armësh. I ka njohur të shtënat që vinin nga pistoletat. Të shtënat kanë zgjatur aq kohë sa të duhet me pirë një cigare. Pastaj ai ka parë **S. I.** dhe **A. I.** duke u larguar nga ndërtesa së bashku me punëtorët e tjerë të komunës. Zt. N. I., është takuar më herët në atë ditë, me të Akuzuarin J. I. por nuk e ka vurë re nëse ai është larguar nga ndërtesa e Komunës së bashku me dy të Akuzuarit e tjerë. Kur Z. N. I. ka qenë jashtë ndërtesës, ai ka parë që A. K. ishte i lënduar dhe i është dhënë ndihma e parë nga personeli mjekësor. Ky dëshmitar gjithashtu konfirmoi që I. H., i lënduar rëndë, është lënë për një kohë të gjatë në korridorin e Komunës. Sipas deklaratës së tij, pasi policia ka arritur në ndërtesën e Komunës, ai kishte dëgjuar që dikush ishte vrarë brenda ndërtesës; kështu që ai vendosi të hyjë në Komunë të ndihmonte viktimën dhe gjeti I. H. të lënduar në syrin e tij dhe të shtrirë në korridor, ngjitur me zyrën nr. 4, por akoma i gjallë dhe i vetdijshëm; pastaj, me ndihmën e Kryetarit të Komunës, Zt. S. L., ai ka nxjerrë Zt. I. H. jashtë ndërtesës dhe e futi në një fugon.

Znj. S., e cila punon në gjendjen civile të Komunës, tha që më 24 Qershor 2010, një ditë normale pune, rreth orës 08:30 para dreke, ajo ishte në zyrën e saj (nr. 4) së bashku me kolegen e saj B. K. kur ka dëgjuar të shtëna armësh në korridor. Gjatë të shtënave, një person i panjohur, që kishte të veshur një këmishë të bardhë, hyri brenda dhe përmes zyrës, doli përjashta nga dritarja. Ajo qëndroi në zyrë deri sa të gjithë të shtënat pushuan. Të shtënat zgjatën për 15-30 minuta. Pastaj ajo u largua nga dritarja.

Znj. K., e cila punon si arkiviste në Komunën e S., konfirmon që ajo ishte në zyrën nr. 4 së bashku me Z. Spahiu kur, dikur pas orës 8.00 para dreke, ka dëgjuar disa të shtëna. Pastaj, dikush i panjohur i veshur me këmishë të bardhë, ka hyrë në zyrë i paarmatosur dhe është larguar nga dritarja. Dëshmitarja nuk ka parë ndonjë armë tek ky person. Ajo ka dëgjuar që dikush po rënkonte në korridor. Pas 15-20 minutash nga fillimi i të shtënave, ajo vendosi që të largohej nga zyra nga dritarja. Znj. S. ka bërë të njëjtën gjë, menjëherë pas saj.

Nga ana e tjetër, dëshmia e Znj. Sh. H., e cila punon në Komunë dhe është përgjegjëse e kalimit të pronësive, ishte krejtësisht e parëndësishme sepse ajo nuk ishte në vendin e punës në ditën kritike. Ajo tha që normalisht ajo arrin në punë nga ora 9.00, pra pasi që incidenti ka ndodhur. Dëshmia e saj trajtoi kryesisht faktin që, ditën para incidentit, dy persona (ajo nuk ishte e sigurtë nëse ato ishin palët e dëmtuara A. K. dhe I. H.) erdhën në zyrën e saj që të marrin një certifikatë për kalimin e pronësisë; ajo gjithashtu dha disa informacione në rastin e pronës në lidhje me konfliktin dhe në procedurën se si bëhet transferimi i pronës; këto çështje megjithatë, nuk kanë rëndësi direkte për vendimin e akuzës.

Dëshmia e Zt. V. M. konfirmon që A. K. ishte lënduar. Më 24 Qershor 2010, dëshmitari që punon në klinikën private në Skenderaj ishte në rrugë përjashta përpara klinikës e cila është afër Komunës. Ai kishte parë A. K. duke u përkulur. Meqenëse e njihte atë, ai iu afrua atij dhe e çoi në klinikë që t'i jepte ndihmën e parë. Ai pastaj e kuptoi që ai ishte i lënduar dhe po

humbiste gjak kështu që u largua nga klinika e tij dhe shkoi të thirr ndihmën mjeksore nga qendra mjeksore aty afër.

Dëshmia e dëshmitarit F. B.

Zt. B. dëshmoi që me 24 Qershor, në mëngjes, ai shkoi në punë në Komunën Skenderaj dhe pastaj shkoi te zyra e J. I. sepse donte që të bënte kopje të disa dokumenteve. Gjatë kohës që ishte atje, ai dëgjoji të shtëna armësh – një e shtënë u dëgjua në fillim dhe pastaj të shtëna të tjera. Dëshmitari i tha J. I. që të mbyllte derën e zyrës dhe ai e mbylli. Atëhere Zt. B. u largua nga zyra nga dritarja dhe J. I. bëri të njejtën gjë. Ato shkuan prapa ndërtesës së Komunës dhe takuan F. B. atje. Ata që të dy vazhduan rrugën në drejtim të një parku dhe rrugës së asfaltuar ku qëndruan për pak kohë dhe pastaj u ndanë.

Dëshmia e Dëshmitarit Expert Doktor G.

Dëshmia e dëshmitarit experto-ligjor, Doktor G., vërtetoi që lëndimet e vuajtura nga I. H. dhe A. K. janë mjaft të rënda që të rrezikojnë jetën. Nga një kërkesë e Mbrojtjes, ai u ftua që të dëshmoj në lidhje me shkakun, natyrën dhe pasojat e lëndimeve dhe pozicioni nga të cilat plagët janë shkaktuar. Pasi i mori dokumentet relevante mjeksore që ishin në dosje, ai parashtrroi mendimin e tij me shkrim dhe është egzaminuar në Gjykatë nga palët.

Në lidhje me I. H., vlerësimi i tij i raportit mjeksor zbuloi që: në ditën e aksidentit Pala e Dëmtuar është sjellë në Qendrën e Urgjencës në Prishtinë; një plagë (vrimë hyrje) e shkaktuar nga një arm zjarri, ishte gjetur në anën e majtë të kafazit gjoksit në zonën e djathtë të supraklavicularit; raporti nuk ka identifikuar vrimën e daljes; plaga kualifikohet si lëndim i rëndë trupror, e rrëzikshme për jetën; Pala e Dëmtuar pati një tjetër plagë në kokërdhokun e syrit të majtë, me çarje të shumta të syrit dhe kockave të faqeve; bazuar në dokumentat e disponuara, nuk ishte e mundur të përcaktohej nëse plaga në sy është shkaktuar nga armë zjarri; kjo plagë kualifikohet si lëndim i rëndë trupror me humbje të përhershme të një organi të rëndësishëm jetësor. Në të njejtën ditë, ai ka marrë disa doza gjaku dhe iu nënshtrua ndërhyrjes kirurgjikale pas së cilës kokërdhoku i syrit ishte hequr. Ai u lirua nga qendra e Urgjencës pas 15 ditësh.

Në lidhje me A. K., vlerësimi i ekspertit në raportin mjeksor zbuloi që: në ditën e aksidentit Pala e Dëmtuar ishte sjellur te Qendra e Urgjencës në Prishtinë ku është mjekur për 8 ditë. Tre plagë i janë gjetur atij të shkaktuara nga armëzjarri: njëra plagë në anën e djathtë të zonës së kafazit të kraharorit; një plagë hyrëse në anën e djathtë të zonës së mesit; një plagë në zonën e gjurit të djathtë; këto plagë kualifikohen si lëndime të rënda truprore, të rrëzikshme për jetën. Ai iu desh t'i nënshtohet operacionit.

Dëshmitari ekspert tregoi që, në baza të dokumenteve mjeksore të disponueshme, ishte e pamundur të përcaktosh pozicionin vrimave hyrëse dhe dalëse, trajekoret e lëndimeve dhe pozicionin e mundshëm të Zt. K. dhe Zt. H. në momentin e të shtënave. Dëshmitari ekspert gjithashtu nënvizoi që nuk ishte në gjendje të dëshmonte për lëndimet e vuajtura nga F. Xh.

sepse nuk i kishte patur në disponim ndonjë dokumentacion mjeksor për të. Por, plagë gjakëderdhje e vuajtur nga Zt. Xh. në këmbën e majtë, ishte parë nga oficerët e policisë që ndihmoi atë menjëherë pasi ai ishte larguar nga Komuna (shihni raportin e oficerit të datës 24 Qershor 2010, Dosja #I e dosjes së Prokurorisë, në f. 96).

Deklaratat e dy të Akuzuarëve S. I. dhe A. I.

Tregimi i incidentit të dhënë nga të dy të Akuzuarit në deklaratën e tyre në Gjykatë pajtohet me prezantimin e fakteve si në vijim.

Në mëngjesin e datës 24 Qershor 2010, **A. I.** takoi kushëririn e tij **S. I.** në Skenderaj dhe i kërkoi atij që ta shoqëronte atë te ndërtesa e Komunës që të takonte babain e tij (dhe daja i **S. I.**) **M. I. 2.** **A. I.** e dinte që Zt. **M. I. 2.** ishte në Komunë sepse ai supozohej të takonte një avokat të diskutoj konfliktin me Palët e Dëmtuara në lidhje me një pronë të paluajtshme të kontestuar. Pasi të dy të Akuzuarit hyrën në ndërtesë, ato dëgjuan zëra të lartë dhe panë të tre Palët e Dëmtuara në korridor. Meqenëse ato menduan që Palët e Dëmtuara ishin duke u zënë me Zt. **M. I. 2.**, ato e shpejtuan të ecurin në drejtim të tyre. Në atë moment, I. H. i mallkoi ato. Kur iu afruan afër I. H., afërsisht një metër nga ai, H. nxora pistoletën dhe donte të qëllonte ato, por **S. I.** mundi që të gjuante me këmbë në dorën e tij, kështu që e shtëna u qëllua në ajër.

Në këtë pikë **S. I.** dhe **A. I.** u larguan nga korridori. Ky i fundit tha që pas të shtënës së parë nga Zt. H., e cila ishte devijuar nga **S. I.**, edhe A. K. dhe F. Xh. kanë nxjerrë armët e tyre dhe filluan të qëllonin tek ato. Në përgjigje, **A. I.** ka nxjerrur pistoletën e tij gjithashtu dhe, kur po largohej me shpejtësi, ka qëlluar pesë herë me radhë, që do të thotë, pa marrë në shenjestër në ndonjë gjë të veçantë. Ai shtoi që, gjatë kohës që ka patur armën pa leje që prej lufte, ai zakonisht nuk e ka mbajtur me vete. Por në atë ditë, ai kishte vendosur që ta merrte atë, meqenëse ai priste probleme me Palët e Dëmtuara. Nga ana e tjetër, në një pjesë tjetër të deklaratës së tij, **A. I.** tha që, para incidentit, nuk ka patur ngatërresë me Palët e Dëmtuara lidhur me pronën e kontestuar dhe që nuk priste të shikonte Palët e Dëmtuara në Komunë në atë ditë. **S. I.** në fakt, gjatë largimit, nuk ka parë as kushëririn as Palët e Dëmtuara duke qëlluar. Veçse, ai ka dëgjuar, kur po largohej, tre apo katër të shtëna prapa atij në një kohë prej 10-15 sekondash. Veçse më vonë, **A. I.** i tregoi atij që ishte i armatosur në atë ditë dhe që kishte shtënë në korridor.

Pasi ato arritën të largohen nga ndërtesa dhe u larguan me makinë, nuk shkuan në polici të raportojnë që ata ishin sulmuar. Ata shkuan në polici vetëm në datën 9 Korrik 2010, kur **A. I.** dorëzoi armën në polici që ka përdorur në ditën e aksidentit (shihni për këtë pikë, listën e artikujëve të konfiskuar të datës 9 Korrik 2010 në fq. 59-60 të Dosjes #II të Prokurorisë).

Vlerësimi i provave

Që të dyja, Pala e Dëmtuar dhe të Akuzuarit, kanë pranuar që shkak i incidentit në Komunë në ditën kritike ka qenë për një mosmarrëveshje të pronësisë të një pjesë toke që gjendet

poshtë Skenderaj. Gjatë kohës që Pala e Dëmtuar ishte në negociata për blerjen e pronës me pronarët Serbë të Kosovës, të Akuzuarit pohuan që toka i përkiste familjes së tyre, sepse ajo ishte shpronësuar në mënyrë të paligjshme nga ata pas Luftës së Dytë Botërore gjatë regjimit Jugosllav.

Dëshmitë e Palës së Dëmtuar në lidhje me incidentin në Komunë janë në përputhje që të dyja, të marra një nga një dhe nëse ballafaqohen me njëra tjetrën. Kështu që ato paraqesin një version të fakteve kritike.

Identifikimi i tyre për **S. I.**, si personi që filloi i pari duke qëlluar kundër atyre, është i besuar. F. Xh. e ka përmendur atë në deklaratat e tij para policisë më 2 Korrik 2010, dmth para se të dy të Akuzuarit të dorzoheshin në polici. I. H. ka njohur atë përmes një fotografie të rreshtuar gjatë pyetjeve para prokurorit dhe në prezencë të avokatit mbrojtës të dy të Akuzuarëve në datën 6 Shtator 2010. Ai shtoi në Gjykatë që **S. I.** kishte një mjekër në formë mjekër cjapi, e cila është konfirmuar nga fotografia e të Akuzuarit në çastet e arrestit të tij më 9 Korrik 2010 (shihni f. 230 në Dosjen #II të Prokurorit).

Gjithashtu, ata mund të identifikonin **A. I.** si personin tjetër që qëllonte kundër tyre. I Akuzuari vetë e pranoi që atë ditë ishte në Komunë dhe qëlloi me armën e tij. Veç kësaj, Zt. I. ka parë **S. I.** dhe **A. I.** duke hyrë në Komunë dhe duke iu larguar asaj nga hyrja kryesore pas të shtënave.

Dëshmitarët N. I., H. S. dhe B. K. vërtetuan në dëshminë e tyre në Gjykatë disa aspekte të rëndësishme të versionit të dhënë nga të tre Palët e Dëmtuara. Dëshmia e dëshmitarit mjekoligjor, Doktor G. vërtetoi që lëndimet e vuajtura nga I. H. dhe A. K. ishin mjaftë të rënda që të rrezikojnë jetën e tyre.

Gjykata është në dijeni të plotë të faktit që asnjë dëshmitarë përveç palëve të dëmtuara në të vërtetë, kanë parë se si të shtënat kanë ndodhur dhe, në veçanti se kush ka qëlluar i pari: të dy të Akuzuarit ashtu siç pretendojnë Palët e Dëmtuara, apo I. H., ashtu siç ka thënë **A. I.** dhe **S. I.**? Skenari i fundit, nëse të ishte provuar, mund të kishte çuar në një shfaqsim në baza të vetmbrojtjes.

Për të vërtetuar këtë fakt kyç, Kolegji u mbështet në konstatimet që erdhën nga raporti balistik, mjeko-ligjor dhe mjeksor të krahasuara këto me dëshmitë e dhëna nga të Akuzuarit dhe Palët e Dëmtuara me synimin për të krijuar se cilin version i fakteve është koherent dhe i besueshëm. Si rezultat, Kolegji ishte në gjendje të përjashtonte përtej dyshimit të arsyeshëm, që Palët e Dëmtuara ishin të parët që qëlluan kundër të Akuzuarëve. Kjo është sepse deklaratat e dhënë nga të dy të Akuzuarit në këtë pikë janë krejtësisht të pabesuara pasi ata prezantojnë shumë aspekte kontradiktore dhe të palogjikshme.

Së pari, sipas versionit të të Akuzuarëve, të tre Palët e Dëmtuara ishin të gjithë duke qëlluar ato, ku veçse Avdyli ka shtënë prapa pa marrë shënjestër ato; duke dhënë këtë, nuk është reale të pranosh që përderisa të dy të Akuzuarit arritën të largohen nga të shtënat e tre armëve

pa një gërvishtje, ku në fakt Palët e Dëmtuara janë qëlluar, dy herë (Zt. H.), tre herë (Zt. K.) dhe një herë (Zt. Xh.) nga arma e vetme e **A. I.** i cili, sipas vetes tij, ka qëlluar vetëm pesë herë rrjesht ndërsa po largohej.

Së dyti, sipas versionit të **A. I.**, totalisht ishin katër të shtëna armësh, e tija dhe ato të Palëve të Dëmtuara; por, ekspertiza balistike (shihni fq. 72-83 të Dosjes #II të Prosektorëve) vërtetoi që vetëm tre armë (njëra nga ato, arma e **A. I.** e dorëzuar në Polici) ishin përdorur në korridorin e ndërtesës të komunës. Ky konstatim përputhet me versionin e Palës të Dëmtuar sipas së cilës **A. I.**, **S. I.** dhe A. K. ishin duke shtënë në Komunë me tre armë të ndryshme.

Së treti, sipas versionit të Akuzuarëve, I. H. ishte i pari që qëllloi; por versioni i Palës të Dëmtuar që I. H. ishte në telefon në momentin e të shtënave, në fakt gjenë një konfirmim të fortë sepse telefoni ishte gjetur në dyshejen e korridorit pikërisht aty ku I. H. ishte qëlluar (shihni fotot në fq. 150, Dosja #II e Prokurorit). I. H. konfirmoi, kur jepte deklaratën e tij para Gjykatës, që ishte pikërisht ky telefon që po e përdorte në at çast.

Së katërti, sipas versionit të të Akuzuarëve, incidenti zgjati pak sekonda meqenëse ata u larguan nga korridori menjëherë sapo filluan të shtënat; por, sipas dëshmitares H. S. dhe B. K., të shtënat kanë zgjatur më shumë (ndërmjet 15 dhe 30 minuta) dhe nuk ishte veçse një shkëmbim i shkurt i të shtënave. Dëshmitari N. I. konfirmoi këtë informacion duke thënë që të shtënat kanë zgjatur aq kohë, sa të duhet që të pishë një cigare.

Së pesti, nëse të tre nga Palët e Dëmtuara ishin duke qëlluar kundrejt dy të akuzuarëve, thjeshtë nuk është e mundur të mos ketë gjurmë plumbash apo plumba të gjetur në pjesën e korridorit ku të dy të Akuzuarit kanë qëndruar (shiko fq. 33-38 dhe fotografitë në fq. 123, të Dosjes #II të Prokurorit) Është e arsyeshme të presësh që nëse tre armë ishin duke qëlluar në të njëjtën kohë në drejtim të të dy Akuzuarëve ndërsa po largoheshin nga vend ngjarja, ose të Akuzuarit do të ishin lënduar, ose muret, porta dhe/apo tavani i korridorit në Komunë, ndërtesa duhet të ishte goditur nga disa plumba. Asnjëra nga këto, faktikisht nuk ndodhi. Përkundrazi, numër i konsiderueshëm gjurmë plumbash dhe gëzhgojash ishin gjetur në fundin e largët të korridorit, pikërisht përball ku të Akuzuarit erdhën dhe u larguan. Këto konstatime vërtetojnë versionin e ngjarjes të Palëve të Dëmtuara, pra, që të dy të Akuzuarit ishin duke qëlluar nga vendi që ato hynë në korridor në drejtim ku Palët e Dëmtuara ishin duke qëndruar në mes të korridorit përballë me zyrën Nr. 4.

Së gjashti, nëse ishte e vërtet që të tre Palët e Dëmtuar ishin duke qëlluar të dy të Akuzuarit dhe veçse **A. I.** ishte duke qëlluar prapa ndërsa po largoheshin, atëhere nuk do të kishte arsye që të dy prej Palëve të Dëmtuara të kërkojnë strehim në zyrën e komunës dhe të largoheshin nga dritaret ndërsa i treti ngeli në korridor i plagosur rëndë. Në zyrën nr. 8, raporti mjekoligjor diktoi një plumb dhe dy gëzhgoja, veç kësaj një njollë gjaku ishte gjetur në buzë të pjesës së jashtme të dritares të zyrës nr. 8; kjo vërtetonte versionin e A. K. që ai kërkoi strehim në atë zyrë, po qëllonte nga atje dhe përfundimisht u largua nga dritaria (shiko fq. 43-45 të Dosjes #II së Prokurorit). Për më tepër, H. S. dhe B. K. ishin në zyrën nr. 4 kur ato panë që

dikush u fut dhe u largua nga zyra përmes dritares; kjo vërteton versionin e F. Xh. që ai u largua nga ndërtesa përmes zyrës.

Së shtati, deklarata e **A. I.** që nuk ka patur ndonjë kontestim me Palët e Dëmtuara dhe që ai nuk e parashikonte të takonte ato në Komunë është kundërshtuar nga deklarata e vetë atij në gjykatë që ai po mbante një armë veçanërisht atë ditë sepse ai po priste të ketë “probleme” me Palët e Dëmtuara.

Kolegji e ka marrë parasysh që dëshmitari ekspert nuk ishte në gjendje të jepte vlerësimin e vendit të mundshëm të Palëve të Dëmtuara dhe të dy të të Akuzuarëve në momentin në të cilën A. K. dhe I. H. janë qëlluar. Pa mohuar rëndësinë e kësaj çështje, kolegji mendon që as një raport i ri balistik dhe as një rindërtim skene pas dy vjetësh nga ngjarja do të paraqiste më tepër prova mbi këtë.

Sipas konstatimit të mësipërm, Gjykata konsideron që fakte e përshkruara në dispozitivin nën këtë pikë, janë provuar përtej dyshimit të arsyeshëm.

B) Provat në lidhje me akuzat e Pronësisë, Kontrollit, Posedimit apo Përdorimit të Paautorizuar, të Armëve, në kundërshtim të Nenit 328, Paragrafi (2) i KPK-ës kundër S. I. dhe A. I..

Në baza të evidencës të përshkruar më lart nën paragrafin (A) si më sipër, është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm që **A. I.** posedonte për disa vjet dhe e ka përdorur në ditën kritike pistoletën “CZ modeli 52” me numër serial “M 09385”; Që të dy nuk kishin leje për armët.

C) Provat në lidhje me akuzat e Ndhimesës në kryerjen e veprës penale të Tentativës për Vrasje të Rëndë, në kundërshtim me Nenin 147, Pika 4 dhe 11, në conform me Nenin 25, paragrafi 1 dhe 2 i KPK-ës kundër J. I..

Asnjë provë nuk doli gjatë gjykimit në lidhje me këtë akuzë. Veçanërisht, asnjë pjesë e provave nuk duket se tregon pjesëmarrjen se **J. I.** po ndihmonte dy të Akuzuarit të largoheshin nga vend- ngjarja dhe më pas të fshihte gjurmët e incidentit. Përkundrazi, që të dy dëshmitarët F. B. 1. dhe F. B. 2. dhanë dëshmi të besueshme që shfaqsonin J. I. Ky i pari tha që ai ishte me të Akuzuarin, në zyrën e tij në Komunë kur dëgjuan të shtëna jashtë në korridor. Zyra e të Akuzuarit (zyra nr. 6) është në fund të korridorit në të djathtë. Dëshmitari shtoi që ato që të dy u larguan nga zyra përmes dritares dhe që ishte me të Akuzuarin derisa ato arritën te një kryqëzim ku u ndanë. F. B. 2. konfirmoi që i ka parë që të dy të Akuzuarit dhe Zt. F. B. 1. afër Komunës pasi ato ishin larguar nga ndërtesa.

Sipas konstatimeve të mësipërme, Gjykata konsideron që faktet e përshkruara në dispozitivin nën këtë pikë nuk janë provuar.

5. Kualifikimi ligjor.

Që të dy të Akuzuarit **S. I.** dhe **A. I.** janë shpallur fajtorë për veprat penale të Tentativës për Vrasje të Rëndë në kundërshtim me Nenin 147, pika 4 dhe 11 në lidhje me Nenin 20 dhe 23 të KPK-ës.

Neni 20 (Tentativë) lexon: Kushdo që me dashje ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për kryerjen e veprës penale dhe vepra nuk është kryer ose elementet e veprës së qëllimshme penale nuk janë realizuar, ai konsiderohet se ka tentuar të kryejë vepër penale.

Neni 23 (Bashk-Kryerja) lexon: Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepra penale.

Neni 147 (Vrasje e Rëndë) pika 4 dhe 11 lexojnë: “Me së paku dhjetë vjet burgim apo me burgim afatgjatë dënohet personi i cili: 4) Privon nga jeta personin tjetër dhe me atë rast me dashje e vë në rrezik jetën e një ose të më shumë personave; 11) Me dashje kryen dy apo më shumë vrasje”.

Konstatimet e vërtetuara si më sipër dhe të përshkruara në dispozitiv, i plotësojnë të gjitha elementet e këtyre dispozitave. Domethënë, është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm që Të Akuzuarit së bashku kanë kryer sjelljen kriminale pasi të dy kanë qëlluar të tre Palët e Dëmtuara me pistoletat e tyre përkatëse. Sjellja e tyre kriminale kualifikohet si tentativë të vrasësh të tre Palët e Dëmtuara meqenëse veprimi i të shtënave për një periudhë të stërzgjatur, një numër plumbash në drejtim të tre qenieve njerëzore në një distance shumë të afërt dhe vend shumë të ngushtë, qartësisht kualifikohet si një veprim i menjëhershëm drejt kryerjes së veprës. Është e rëndësishme të shënosh në këtë drejtim, që është e parëndësishme nëse të dy të Akuzuarit ia dolën mbanë të qëllonjë së paku njërin prej Palëve të Dëmtuara. Vërtetimi se cili saktësisht ka lënduar të tre Palët e Dëmtuara dhe se sa herë, është njëlloj e parëndësishme. Kjo është për arsye se konstatimi i Vrasjes në Tentativë, nuk kërkon që viktimi në fakt të jetë goditur. Çfarë është e nevojshme është “veprimi i menjëhershëm” i përshkruar si më sipër dhe qëllimi të vrasësh.

Mens rea i të dy të Akuzuarve është vërtetuar në baza të rrethanave faktike të incidentit që u përmend më parë. Të shtëna të shumta me armë zjarri të një grup prej tre personave relativisht nga një distancë e afërt brenda një hapësire të ngushtë si në korridor, qartësisht tregojnë qëllim për të vrarë. Dy nga të tre Palët e Dëmtuara mund të kishin vdekur lehtësisht, në baza të lëndimeve që kanë marrë. Ishte gjithashtu veçse një rastësi në atë që Pala e Dëmtuar F. X., ka marrë veçse një plagë në gjurin e tij, e cila nuk i shkaktoi ndonjë rrezik për jetën e tij dhe që ishte aq afër hyrjes të zyrës Nr. 4, sa që ai mund të hynte dhe nuk ishte më i ekspozuar ndaj të shtënave në vazhdim e sipër në korridor. E gjitha kjo tregon që të Akuzuarit nuk kanë qëlluar me qëllim që të frikësojnë apo të shkaktojnë disa lëndime Palëve të Lënduara. Veç kësaj, që të dy të Akuzuarit patën një motiv të qartë, d.m.th. konflikti ndërmjet familjes tyre dhe të Palëve të Dëmtuara në lidhje me pronën e kontestuar të tokës në Skenderaj.

Për sa i takon elementit të vrasjes së rëndë nën pikën 4, është vërtetuar që të paktën katër persona përveç Palëve të Dëmtuara, ishin brenda zyrës në korridor ku ka ndodhur incidenti, në një distancë të afërt nga trajektoret e plumbave. Të Akuzuarit ishin në dijeni të faktit që

nga të shtënat disa herë në një ndërtesë publike gjatë orëve të punës, ato mund të rrezikonin jetën e shumë personave ashtu siç në fakt ndodhi. Fakti që asnjë person nuk u lëndua përveç Palëve të Dëmtuara, është e parëndësishme meqenëse rreziku i jetës është element i kërkuar. Dënimi nën pikën 11 është bazuar në faktin që të Akuzuarit kanë tentuar të vrasin tre persona.

Të gjitha elementet e akuzës të Mbajtjes në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve, në kundërshtim me Nenin 328, Paragrafi (2) i KPK-ës kundër të dy Akuzuarve është provuar, siç e nënvizuar në vlerësimin e dëshmive dhe përcaktimin e fakteve si më sipër.

6. Dënimi

Kur Gjykata shqipton sanksionin penal, duhet të ketë parasysh qëllimin e përgjithshëm të dënimit – për të shtypur aktivitetet shoqërore të rrezikshme që të ndalojnë të tjerët nga kryerja e veprave të ngjashme penale – dhe qëllimi specifik – për të parandaluar shkelësit nga përsëritja e kundërvajtjes. Në rastin konkret, Kolegji arriti në një përfundim që, vetëm duke zbatuar dënimin e shqiptuar të burgimit, do të arrihet qëllimi i dyfishtë i lart-përmendur. Në përcaktimin e kohëzgjatjes së dënimit me burgim, Gjykata ka vlerësuar të gjithë faktorët lehtësues dhe keqësues, sipas Nenit 64, Paragrafi (1) i KPK-ës) duke mbetur brenda kufijve të dënimeve të parashikuara me ligj.

Sa i përket qëllimit të përgjithshëm të dënimit, kolegji konsideron se vrasjen ose tentativa për të vrarë një qenie njerëzore për shkak të një mosmarrëveshje të pronës është jashtë çdo dyshimi, një aktivitet jashtëzakonisht i rrezikshëm që nuk duhet të tolerohet në çdo shoqëri. Të gjitha çështjet e pronës duhen të referohen nga qytetarët në gjykatat kompetente të Kosovës dhe nuk zgjidhen duke përdorur armë.

Krimi i vrasje të rëndë është e dënueshme me burgim prej së paku dhjetë vjet deri në një maksimum prej njëzet vjet ose me burgim afatgjatë prej njëzet e një deri në dyzet vjet. Ashtu siç Kolegji vendosi, se kushtet sipas nenit 37 (1) KPK-ës për shqiptimin e burgimit afatgjatë nuk u plotësuan, dënimi i zbatueshëm nuk mund të jetë më shumë se tre të katërtat e njëzet vjetëve, për shkak të zbutjes së dënimit, në rastin e krimit në tentativë sipas nenit 65 (2) të KPK-ës.

Kolegji konstatoi si rrethana lehtësuese që të dy Akuzuarit nuk kanë asnjë dosje penale dhe se ata ishin dy të rinj në kohën e incidentit. Kolegji konstatoi si rrethana rënduese se të shtënat ndodhën në një ndërtesë publike brenda orarit të punës dhe që ka shkaktuar lëndime të rënda trupore te të dy palët e dëmtuara, duke përfshirë humbjen e përhershëm të njërit prej syve.

Meqenëse Kolegji nuk mund të gjente ndonjë element të rëndësishëm duke diferencuar nivelin e përgjegjësisë të njërit të Akuzuar nga tjetri, vendosi për të ndëshkuar të dy të Akuzuarit me nëntë vjet burgim.

Në lidhje me akuzën e Mbajtjes në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve, Kolegji ka marrë parasysh që, ndryshe nga **A. I.**, nuk është vërtetuar se **S. I.** ka pasur një armë në posedim të tij para incidentit. Prandaj Kolegji vendosi të dënoj **S. I.**, në një vit e gjysmë burgim për përdorim të armës pa leje, dhe **A. I.** në dy vjet burgim

për posedim dhe përdorim të një arme. Dënimi i përmbledhur është përcaktuar si nëntë vjet e nëntë muaj për të parin dhe dhjetë vjet për këtë të fundit.

7. Artikujt e konfiskuar

Tipi i pistoletës "CZ modeli 52" me numër serial "M 09385", të kalibrit 7.62 x 25, e përdorur nga **A. I.** të kryej Vrasjen në Tentativë është konfiskuar në pajtim me Nenin 60 Paragrafi (1) dhe Nenit 328 Paragrafi (5) i KPK-ës.

8. Shpenzimet

Pas llogaritjes së shpenzimeve, është vendosur që **A. I.** dhe **S. I.** do të paguajnë 261 euro secili, si pjesë e tyre e shpenzimeve të procedurës penale, duke përfshirë pagesën e dëshmitarëve ekspert dhe duke përjashtuar shpenzimet e interpretimit dhe përkthimit, në pajtim me Nenin 102 Paragrafi (1) i KPPK-së.

J. I., nga ana tjetër, lirohet nga pagesa e ndonjë shpenzime në lidhje me procedurën meqenëse ai është shfajësuar nga të gjitha akuzat.

9. Kërkesa Pronësore

Meqenëse Palët e Dëmtuara nuk kanë paraqitur ndonjë kërkesë për kompensim gjatë gjyqimit, ata janë të udhëzuar që në pajtim me Nenin 112 (2) të KPPK-së ata mund të ndjekin pretendimet për kompensim në kontest civil.

GJYKATA E QARKUT në Mitrovicë P.nr. 06/2011

E përgatitur në Anglisht, në gjuhë të autorizuar.

Francesco de Sanctis
Oficer i regjistrimit

Nikolay Entchev
Kryetari i Trupit Gjykes

Katia Dominik
Anëtare Kolegji

Beqir Halili
Anëtar Kolegji

Mjetet juridike:

Personat e autorizuar mund të paraqesin ankesë në formë të shkruar kundër këtij vendimi në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data që kopja e vendimit është marrë, në bazë të Neneve 398 dhe 399 të KPPK-ës.

